

27.11.2018



C.nr. 96/15

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses [REDACTED] nga Ferizaji rr' [REDACTED] "nr. [REDACTED] të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson avokati [REDACTED], nga Ferizaji, kundër të paditurit [REDACTED], nga Ferizaji, tani me adresë të panjohur të vendbanimit, të cilin në cilësinë e përfaqësuesit të përkohshëm e përfaqëson avokati [REDACTED] nga Ferizaji baza juridike vërtetimi i pronësisë, më datë 26.11.2018 mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] nga Ferizaji, dhe vërtetohet se paditësja [REDACTED] nga Ferizaji është pronarë e ngastrës kadastrale nr.1011-7, në sipërfaqe prej 557 m², e cila gjindet në vendin e quajtur "Arat e Tullave, Zona Kadastrale në Ferizaj.

II. Detyrohet paditësja [REDACTED] nga Ferizaji që kësaj gjykate në emër të shtesës së taksës gjyqësore për padi t'ia paguaj shumën e të hollave prej 75 euro.

Arsyetim

Paditësi [REDACTED], ish [REDACTED] nga Ferizaji, me datë 13.02.2015, ka parashtruar padi në këtë Gjykatë, kundër të paditurit [REDACTED], nga Ferizaji tani me adresë të panjohur të vendbanimit, me bazë juridike vërtetimi i pronësisë për ngastrën kadastrale nr.1011-7, në sipërfaqe prej 557 m², e cila gjindet në vendin e quajtur "Arat e Tullave, Zona Kadastrale në Ferizaj.

Paditësi [REDACTED] në padi ka deklaruar: paditësi nga i padituri, në bazë të kontratës në vitin 1960 e ka blerë paluajtshëmërinë, ngastrën kadastrale nr. P-72217092-1011-7, në sipërfaqe prej 557 m², e cila gjindet në vendin e quajtur "Arat e Tullave", në të cilin trull ekziston shtëpia e banimit që evidentohet në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluejtshme, i padituri i ka dorëzue në posedim dhe shfrytëzim të lire patuendshmërinë e kontraktuar paditësit të cilën paditësi me familjen e tij e shfrytëzon pa pengese edhe tani. Në patuendshmërinë e cekur paditësi është në shfrytëzim dhe posedim faktik të papenguar më shumë se 50 vite dhe bartja nuk është bërë deri më tani pasi prej vitit 1981 ka ekzistue ndalesa e bartjes së pronësisë nga shitësit të nacioliteti serbë në blerësit të naciolitetit shqiptarë. Paditësi ka interes juridik që kjo çështje të vërtetohet përmes

gjykatës meqë gjendja faktike nuk perputhet me gjendjen kadastrale pasi që pasuria lëndore edhe më tutje udhëheqet në emër të të paditurit.

Me datë 18.03.2015 paditësi [REDAKTUAR] ka vdekur ,kurse me një parashtrësë të dorëzuar në këtë gjykatë procedurën e ka marrë përsipër trashëgimtarja- bashkëshortja e tij tani paditësja [REDAKTUAR] nga Ferizaji,me parashtrësin e datës 02.03.2017.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses av. [REDAKTUAR] Ibrahimimi nga Ferizaji ka kërkuar nga gjykata që të vërtetohet se paditësja [REDAKTUAR] nga Ferizaji është pronarë e ngastrës kadastrale nr.1011-7,në sipërfaqe prej 557 m2 ,e cila gjindet në vendin e quajtur"Arat e Tullave,Zona Kadastrale në Ferizaj.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit av. [REDAKTUAR] nga Ferizaji në përgjegjëje në padi ka theksuar: e kontestojnë padin dhe kërkesëpadin e paditësit si të pa bazë dhe pa mbështetje në ligj ,kurse në fjalën përfundimtare ka deklaruar: pas marrjes së padis nga gjykata sipas dispozitave ligjore kam qenë i obliguar të parashtroj përgjegjëje në padi .Unë në përgjegjëje duke mos i njohur provat që do të sjellën në gjykatë ,e kam kontestuar padin dhe kërkesëpadin e paditëses ,un kam njohur familjen e paditëses dhe e di se nga vitit 1963 kur unë jam shpërngulur nga Komogllava familja e paditëses dhe paditësja kanë qenë duke jetuar në paluejtshmërinë kontestuese ,andaj nga provat e sjellura në seancën e sotme shifet se paditësja dhe bashkëshorti i paditëses e kanë pasur në posedim dhe shfrytëzim të qetë prej viteve të 60 paluejtshmërin kontestuese .Nga provat e administruara në këtë seancë shifet se nga ana e të paditurit asnjëherë nuk ka arritur ndonjë kërkesë për denoncu parcelën kontestuese .Andaj i propozoj gjykatës që nga provat e administruara të vendos në mënyrë meritore .Shpenzimet e procedurës i kërkoj për përgjegjëje në padi dhe për tri përfaqësime ,për përgjegjëje në padi 208 euro,për tri përfaqësime nga 270 euro ,gjithsejt për përfaqësime 811 euro.

Me qëllim të vlerërimit sa më të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë qështje civilo juridike janë administruara si provë: certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme,e datës 24.08.2011 me numër UL- 72217092-00950 ,e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj, certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme ,e datës 24.08.2011 ,me numër UL- 72217092-01679 e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj, fatura e tatimit në pronë,e datës 18.01.2014, fatura e lëshuar nga Hidrohigjiena e majit të vitit 2000 , fatura tatimore e datës 02.06.2003, fatura për energjinë elektrike me numër 003525/005, përgjigja e lëshuar nga Agjensia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës e datës 25.maj 2017, me numër ref.nr.00486/17/hj, aktvendimi për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të të ndjerit [REDAKTUAR] LRP .nr.514/2017 i dt. 07.02.2017 i lëshuar nga noteri [REDAKTUAR] certifikata e vdekjes në emër të [REDAKTUAR] e dt. 22.06.2016

nr.1220 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prishtinë, njoftimi i lëshuar nga Policia e Kosovës i dt. 24.04.2018 me numër 04/1-05 F-415/18, historiatit për parcelën kadastrale kontestuese i dt. 29.01.2018 i lëshuar nga Drejtoria për Pronë Kadastër dhe Gjeodezi, ekspertiza e hartuar nga eksperti gjeodet [REDAKTUAR] pjesë e të cilës janë edhe skica e matjes, çertifikata pronësore e dt. 08.10.2018, si dhe fotot e vendit të ngjarjes.

Gjykata i ka vlerësuar provat sipas neni 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjodet [REDAKTUAR] gjykata ka vërtetuar se ngastra kadastrale nr. 1011-7ZK Ferizaj, evidentohet në regjistrin kadastral në emër të të paditurit [REDAKTUAR] nga prindi [REDAKTUAR] me sipërfaqe prej 557 metra katëror. Sa i përket historiatit të kësaj parcele kjo parcelë nuk ka pësuar ndryshime sa i përket titullarit në regjistrin kadastral. Sa i përket gjendjes faktike në të është e ndërtuar një shtëpi P+1 dhe një objekt me etazhitet P+1 që shfrytëzohet si shupë për nevojat familjare. sipërfaqja në fjalë është e rrethuar në pjesën përendimore dhe jugore me murë betoni, kurse në pjesën veriore të saj është rrethuar me tela, kurse pjesa lindore e saj kufizohet apo është e ngjitur faktikisht me parcelën 1011-6 ZK Ferizaj, me pronar [REDAKTUAR]

Me leximin e aktvendimit për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të të ndjerit [REDAKTUAR] ,nr.LRP.nr.514/2017 dhe Ref.T.nr.189/2017 gjykata ka vërtetuar se me këtë aktvendim është shqyrtuar pasuria trashëgimore e të ndjerit [REDAKTUAR] i cili ka vdekur me datë 18.03.2015 ,kurse trashëgimtar i [REDAKTUAR] ishte shpall tani paditësja [REDAKTUAR] kurse trashëgimtarët tjerë të të ndjerit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] kishin heqë dorë nga pjesa pasurisë trashëgimore që u takon sipas ligjit.

Me dëgjimin e dëshmitarit [REDAKTUAR] nga Ferizaji ,rruga [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] gjykata ka vërtetuar se paluejtshmëria kontestuese është blerë nga [REDAKTUAR] të cilit i është paguar në tërësi qmimi i shitblerjes së sajë, kurse paditësi [REDAKTUAR] ka hyrë në posedim të paluejtshmërisë kontestuese dhe ka qenë në posedim të sajë pa u penguar nga askush nga viti 1972 e derisa ka vdekur ,kurse pas vdekjes së [REDAKTUAR] në paluejtshmërin kontestuese jetojnë fëmijët e [REDAKTUAR] dhe Gruaja e tij pa u penguar nga askush [REDAKTUAR] e ka poseduar paluejtshmërin kontestuese më shumë se 40 vite ,në atë mënyrë që ka jetuar në shtëpin që ka qenë e ndërtuar në atë paluejtshmëri si dhe ka mbjedhur bashqë në një pjesë të sajë.

Me dëgjimin e dëshmitarit [REDAKTUAR] nga Ferizaji ,rruga [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] gjykata ka vërtetuar se [REDAKTUAR] paluejtshmërin kontestuese e ka shfrytëzuar më tepër se 40 vite pa u penguar nga askush ashtu që ka jetuar në shtëpin që ka qenë e ndërtuar në

atë ngastër ,një pjesë e ka shfrytëzuar si oborr ,kurse pjesën tjetër e ka shfrytëzuar si bashqe.Në paluejtshmërin kontestuese ka jetuar edhe familja e [REDACTED]

Me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED] nga Ferizaji ,rruga "[REDACTED] gjykata ka vërtetuar se [REDACTED] paluejtshmërin kontestuese e ka shfrytëzuar më tepër se 30 vite pa u penguar nga askush ashtu që ka jetuar në shtëpin që ka qenë e ndërtuar në atë paluejtshmëri ,një pjesë e ka shfrytëzuar si oborr ,kurse pjesën tjetër e ka shfrytëzuar si bashqe.

Me dëgjimin e paditëses [REDACTED] në cilësi të palës gjykata ka vërtetuar se [REDACTED] dhe paditësja e kanë shfrytëzuar paluejtshmërin kontestuese më tepër se 50 vite pa u penguar nga askush ashtu që kanë jetuar në shtëpin që ka qenë e ndërtuar në atë paluejtshmëri ,një pjesë e kanë shfrytëzuar si oborr ,kurse pjesën tjetër e ka shfrytëzuar si kopsht- bashqe.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar si në arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi,sepse bashkëshorti paditëses [REDACTED] e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluejtshmërin kontestuese me parashkrim fitues duke u bazuar edhe në dispoziten e nenit 28 të Ligjit për Mardhëniet Themelore Pronësore Juridike, si dhe nenin 40 të Ligjit Për Pronësin dhe të Drejtat Tjera Sendore, kuptohet për periudhën kohore në të cilën është në fuqi ky ligj ,kurse paditësja të drejtën e pronësisë në paluejtshmërin kontestuese e ka fituar duke trashëguar të drejtën e pronësisë mbi paluejtshmërin kontestuese nga bashkëshorti i sajë në bazë të nenit 2 të Ligjit për Trashëgimin i Kosovës.

Vendimi për shtesën e taksës gjyqësore për padi është bazuar në udhëzimin Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

Me datë :26.11.2018

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC



Gjyqtari

Burim Emërllahu

Më 18.11.2018
Dana 12.11.2018

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmjet të kësaj gjykate.